VENDIM
Nr.595, datë 5.9.2007

PËR DHËNIEN NË HUAPËRDORJE, SHTABIT TË NATO-S NË TIRANË, TË DISA MJEDISEVE NË NDËRTESËN E MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe të pikës 16 të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), për statusin e NATO-s dhe të personelit të saj, ratifikuar me ligjin nr.8543, datë 4.11.1999, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në huapërdorje, për përdorim të përkohshëm, Shtabit të NATO-s, në Tiranë, të disa zyrave, me sipërfaqe trualli, gjithsej 316 m^2, në ndërtesën e Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Afati i kontratës së huapërdorjes të jetë 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
3. Autorizohet Ministria e Mbrojtjes të lidhë marrëveshjen teknike për kalimin, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe për përcaktimin e këtyre mjediseve.
4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha